



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1486/a Prot.

Vlorë më, 21.05. 2026

VENDIM

Nr. 31, datë 21.05.2026

MIRATIMIN E TARIFËS PËR PJESËMARRJE NË "WORKSHOPIN ON FOUNDATIONS OF AI"

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"; nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 6, pika f dhe nenit 7, pika 16 të Rregullores Financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe propozimit të Administratorit, ardhur me shkresën nr. 634/5 prot., datë 04.05.2026, në mbledhjen e datës 21.05.2026, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën për pjesëmarrjen në "Workshopin on Foundations of AI" në vlerën 3,000 lekë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori I Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Enrik Mehmeti

Elmira Kushta

Orkida Hasani

KRYETAR
Saniela Xhaferi

